



SFIDAT E MËSIMIT NË DISTANCË!

Gresa Agushi

Ta mendosh që një molekul mund të vështirësojë e bllokojë gjithë botën është vërtetë një mendim i tmerrshëm, e le më që ky mendim te jetë realitet ashtu siç ndodhi në muajin Mars të vitit të kaluar që nga fillimi i pandemisë duke izoluar gjithë botën dhe duke lënë pasoja të mëdha. Vit ky që ishte mjaftë sfidues për të gjithë ne, ku një sfidë e madhe ishte edhe ne fushen e arsimit. Kjo sfidë ishte mjaftë e vështirë, për shkollat, mësuesit, fëmijët dhe prindërit, të cilëve u duhej të përshtateshin me metodën e re të mësimdhënies dhe të të nxëniet në kushtet e imponuara nga pandemia COVID-19. Njëra prej masave shtrënguese për ta parandaluar përhapjen e Covid-19, në të mirën tonë ishte kalimi i mësimit në mënyrë virtuale por që në vendin tonë kushtet për ta zhvilluar mësimin në këtë mënyrë ishin mjaftë të dobëta dhe shumë fëmijë ishin në rrezik të lënies pas dore. Ku më e vështira ishte për fëmijët që për herë të parë do vijojnë mësimet. E ëndrra që kishin krijuar se si do të njihen me nxënës të tjerë e me mësues mbeti të takoheshin në mënyrë virtuale. Vështirësi kishte edhe në shpjegimin e disa mësimëve poashtu edhe në plotësimin e disa detyrave, derisa u mësua me atë qasje për ne ishte mjaftë problematike.

Mësimi në mënyrë virtuale u transmetua me video- ligjëratat në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK). Në këtë drejtim, krahas videove të transmetuara, mësimdhënësit shfrytëzuan edhe platforma të ndryshme elektronike siç janë ZOOM, Skype, Google Meet, dhe Google Classroom, për të ndarë detyrat e shtëpisë dhe materialet e tjera mësimore, si dhe mundoheshin që mesimet të bënin edhe me të qart. Shpjegimi i disa lëndëve ishte më i vështirë për t'u kuptuar, si shembull i kesaj ishin matematika, fizika, kimia. Ku për të kuptuar një detyrë me formula ishte e nevojshme të përseritej disa herë. Duke filluar nga shkaqet e ndryshme që pavarësisht dëshires së madhe që kemi pasur për të vazhduar mësimin në bankat shkollore, rrethanat e bënin të pamundur poashtu e pamundur ishte edhe që të jesh aktive në secilen orë që zhvillohej.



Mungesa me energji elektrike, kyçja përmes platformës online që ndonjëherë ishte problematike, si interneti i dobët, problemet teknike e tek disa edhe mungesa e paisjeve. Ku ne prisnim që Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të bente zgjidhjen e disa prej këtyre problemeve. Pavarësisht angazhimeve të mesimdhënësve me ne nxënësit, qasja për të kuptuar ishte me e vështirë se sa të jesh prezent në shkollë. Por mësimi online kishte edhe disa të mira ku na bëri të mësojme se si të zhvillojmë aktivitete të ndryshme përmes programeve kompjuterike që e bënin orën edhe më atraktive.

Pa i harruar vështëritë e tjera, ku ndonjëherë nuk mjaftonte edhe ora për ta zhvilluar komplet një njesi nga aktivitetet dhe pyetjet tona, apo edhe largimi automatik nga programi në ndonjë moment që shkaktonte problem të kyçemi sërish. Të gjitha sfidat e lartpërmendura si pasojë e pandemisë rezultojnë në humbje mësimore të nxënësve, që do të kenë ndikime afatgjate në arsimimin dhe të ardhmen e fëmijëve. Humbje mësimore nënkupton humbjen e njohurive dhe shkathtësive apo ngecjes së nxënësve që mund të jetë si rezultat i ndërprerjes së mësimin për arsye të ndryshme, përfshirë: pushimet verore, braktisjen e përkohshme të shkollimit, mungesat e shumta, si dhe mesimdhënien jo-efektive. Që nga fillimi i pandemisë ishte e ditur se do të ketë humbje mësimore, për shkak se mësimi në distancë pa përgatitjet e duhura nuk mund të zëvendësojë procesin e zakon, pavarësisht asaj që kishim kaluar në një pauzë me shpresën që do të kthehemi në normalitet, por duke e parë që ishte e pamundur filluam ta zhvillojmë mësimin me disa programe që kishin zgjedhur Ministria e Arsimit ta mbante.

E me e mira e gjithë kësaj ishte rikthimi sërish në bankat shkollore, ku ne u takuam me shoqerën dhe mesimdhënësuar, gjithmon duke i respektuar rregullat për mbrojtjen nga Covid-19 të cilat tani na ishin bere edhe rutinore si mbajtja rregullisht e maskave, dezinfektimi dhe larja e duarve poashtu edhe distanca mes njeri-tjetrit. Ku ne së bashku biseduam shumë gjera, një pjesë të kohës biseduam edhe rreth problemeve që ne kishim hasur gjatë mësimin online.